



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0338

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi-antare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) ENG Construction SH.P.K., kundër Njoftimit e kontratës ose me dokumentet e tenderit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti" me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1, me, 09.07.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "ENG Construction" SH.P.K., me nr. 2025/0338, e datës 05.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti", me numër të prokurimit; 206-25-80-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
2. Të korigjohet, Dosja Tenderit/ Njoftimi për Kontratë, për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj- vazhdim projekti". Obligohet AK- Ministria e Shëndetësisë, të bëjë përmirësimet në Dosje të Tenderit/Njoftimit për Kontratë, sipas konstatimeve të Panelit shqyrtues, raportit të ekspertit shqyrtues me rekomandim, të mbështetura nga Paneli shqyrtues dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas ligjit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE "ENG Construction" SH.P.K, aprovohet si e pjesërisht e bazuar, i kthehet tarifa ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, sipas nenit 31.4, Rregullorja e Punës OSHP-së. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.04.2025 Ministria e Shëndetësisë, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti me numër të prokurimit 206-25-80-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 27,973,970.95 euro.

Me 14.04.2025, OE ENG Construction SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 25.04.2025.

Me 05.05.2025, OE ENG Construction SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0338, duke e atakuar Njoftimin për kontratë.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ENG Construction SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Ne, si Operator Ekonomik i interesuar me date 03.04.2025 kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, lidhur me kriteret diskriminuese dhe të paarsyeshme të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Megjithëse Autoriteti Kontraktues ka marrë në konsideratë pjesërisht pretendimet tona, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë refuzuar në mënyrë të pajustificuar dhe në kundërshtim me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), përkatësisht me parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë.

Diskriminimi i operatorëve ekonomikë sipas Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042 dhe ndryshimet e mëvonshme) është i ndaluar dhe trajtohet si shkelje serioze e parimeve të prokurimit publik.

1. Parimet themelore të prokurimit (Neni 7)

Ligji përcakton se autoritetet kontraktuese duhet të sigurojnë trajtim të barabartë, mosdiskriminues, proporcional dhe transparencë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Neni 7.1: Autoriteti kontraktues është i detyruar të trajtojë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, dhe të veprojë në mënyrë transparente dhe proporcionale.

Kriteret e papërshtatshme për kualifikim (Neni 61) Vendosja e kriterëve të tepruara që nuk janë të nevojshme për realizimin e kontratës dhe që kufizojnë konkurrencën konsiderohen diskriminuese.

Pretendimet tona janë si më poshtë:

1. Kërkesa për përvojë specifike në një projekt shëndetësor mbi 8 milion euro është diskriminuese dhe joproporcionale

Kjo kërkesë është e tepërt duke marrë parasysh që:

Kërkesa për një kontratë të vetme të realizuar prej 8 milion euro vetëm për objekte shëndetësore përjashton padrejtësisht operatorë ekonomikë që kanë realizuar projekte të ngjashme në kompleksitet dhe vlerë, por në sektorë të ndryshëm si banim kolektiv ose projekte të tjera ndërtimore civile.

AK vetë pranon që projektet banesore kolektive pranohen si përvojë për qëllime të tjera të kriterit (30 milion euro në total), por refuzon të pranojë një kontratë të vetme banesore si ekuivalente për një objekt shëndetësor.

Ky është një standard i dyfishtë dhe krijon avantazh të padrejtë për një pjesë të operatorëve ekonomikë

Sipas kërkesës për rishqyrtim :

Pyetja I

Ne në cilësinë e Operatorit Ekonomik të interesuar për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit Numri i Prokurimit: 206-25-80-5-1-1 Titulli “Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti”, kemi shqyrtuar me vëmendje dokumentacionin e tenderit dhe konkretisht kriterin për përvojën relevante, i cili aktualisht përcakton: “Të ketë realizuar të paktën një kontratë me vlerë së paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim të një objekti shëndetësor (kërkohet për liderin në rast të grupit).” Në këtë drejtim, duke u bazuar në parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, kërkojmë që ky kriter të rishqyrtohet dhe të modifikohet, me qëllim që të lejojë një pjesëmarrje më të gjerë dhe më gjithëpërfshirëse të operatorëve që kanë dëshmuar përvojë të konsiderueshme në fushën e ndërtimit. Kërkesa jonë: Kërkojmë që kriteri i mësipërm të ndryshohet dhe të riformulohet si vijon: "Të ketë realizuar të paktën një kontratë me vlerë së paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim të objekteve ndërtimore."

Arsyetim:

1. Kushti aktual është tepër kufizues, pasi fokusohet vetëm në objektet shëndetësore, duke përjashtuar padrejtësisht operatorë me përvojë të ngjashme në projekte ndërtimore të së njëjtës madhësi, kompleksitet teknik dhe vlerë financiare.

2. Ndërtimi ose renovimi i objekteve të mëdha ndërtimore, qofshin ato banesore kolektive, arsimore, administrative apo tregtare, kërkon të njëjtin nivel kapaciteti teknik, organizativ dhe financiar si edhe objektet shëndetësore. Prandaj, kjo përvojë duhet të konsiderohet e barasvlershme për qëllim të kualifikimit.

3. Kërkesa për përvojë specifike vetëm në objektet shëndetësore nuk lidhet domosdoshmërisht me natyrën e punimeve, të cilat në shumicën e rasteve janë të përgjithshme ndërtimore (konstruktime, instalime, punime të brendshme dhe sistemet ndihmëse).

4. Kufizimi i tillë ngushton padrejtësisht konkurrencën dhe krijon avantazh të padrejtë për një numër shumë të vogël operatorësh, gjë që bie në kundërshtim me nenet themelore të ligjit për prokurim publik dhe praktikën e mira ndërkombëtare. Duke qenë se qëllimi i kërkesës për përvojë është të dëshmojë aftësinë reale për të realizuar një projekt të kësaj shkalle, mendojmë se formulimi alternativ që ne propozojmë i përmbush të gjitha qëllimet e autoritetit kontraktues, ndërkohë që ruan konkurrencën dhe përfshirjen e drejtë të operatorëve me kapacitete të mjaftueshme.

Përgjegjja e Autoritetit Kontraktues:

Ne si Autoriteti Kontraktues e kemi shqyrtuar me kujdes kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe konsiderojmë se është i pa bazuar pretendimi juaj i parë në lidhje me kërkesën e NJK dhe DT që në kuadër të projekteve të kësaj realizimi të paktën një kontratë me vlerë se paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim të një objekti shëndetësor. Vlera e parashikuar e kësaj projekti është afër 28 milion euro dhe kërkesa për se paku një projekt të ngjashëm prej tetë (8) milion euro është plotësisht ligjore për një aktivitet të tillë. Kërkesa e AK është e analizuar mirë, duke marrë parasysh se ne kemi lejuar që përveçsi ndërtim të pranohet ose renovim qka e shton mundësinë e konkurrencës, andaj konsiderojmë se të gjitha kriteret e tenderit janë të arsyeshme duke marrë parasysh qëllimin, vlerën, kategorinë dhe natyrën e aktivitetit. Ne si AK kemi përvojë jo të mirë në të kaluarën pikërisht me këtë projekt, i cili ka mbetur në gjysmë nga ora e paraprak dhe për ne është shumë me rëndësi që punëkryesi i ardhshëm të jetë kompani profesionale dhe me kapacitete të nevojshme për realizimin e projektit, andaj edhe nuk kemi përpiluar shumë kriterë por pak e të duhura, por natyrisht se mund të kete ora të pakënaqur por edhe ora që nuk mund të arrijnë këto kërkesa. Sipas LPP-së lejohet garkullimi financiar në tre vite max. 2fishi i vlerës edhe referencat max. 1.5 e vlerës, por ne i kemi kërkuar shumë me ulët këto vlera që të jenë të përballueshme për ofertuesit e mundshëm. Sikur të kërkohejshin maksimumet e lejuara, vlerat do ishin shumë me lartë se sa vlerat e kërkuara dhe me siguri që ju do ankoheshit edhe me shumë në të. Edhe në projekte tjera të ngjashme kemi pranuar oferta edhe nga jashtë vendit, andaj edhe në këtë rast ora e vendorit e kanë mundësinë e bashkëpunimit në konsorciume me ora të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit.

2. Përfshirja e projekteve të natyrës infrastrukturore, individuale apo të ngjashme nuk ka bazë ligjore dhe është në kundërshtim me vet natyrën e punimeve të tenderuara

Autoriteti Kontraktues ka përfshirë në mënyrë të paarsyeshme projektet e natyrës infrastrukturore, projektet ndërtimore individuale, si dhe të tjera të ngjashme (si nënkalime, ujësjellës, kanalizime), pa ofruar asnjë bazë ligjore konkrete që justifikon këtë përfshirje.

Kjo bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë dhe proporcional të operatorëve ekonomikë dhe përfshirja padrejtësisht shumë subjekte që kanë përvojë të dëshmuar në projekte me kompleksitet, volum dhe standarde të krahasueshme.

Më tej, vetë dokumentacioni i tenderit, përkatësisht paramasat e punimeve të përgatitura nga Autoriteti Kontraktues, përfshijnë një volum të konsiderueshëm të punimeve të natyrës infrastrukturore: si rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit, punime të rrugës, punime të jashtme, etj.

Si e tillë, kërkesa për përvojë të detyrueshme vetëm në objekt shëndetësor, ndërkohë që natyra teknike e punimeve ka shumë elemente të punimeve inxhinierike/infrastrukturore, është jo vetëm e pajustificuar, por edhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me përmbajtjen e vetë tenderit.

Sipas kërkesës për rishqyrtim :

Pyetja II

Gjithashtu kërkojmë sqarim dhe rishqyrtim të kërkesës që thuhet si vijon: “Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimi nga komuna, ndërsa për OE pretendues për kontratë, AK do i verifikojë transaksionet bankare të projekteve private.” Ne jemi Operator Ekonomik i regjistruar jashtë Republikës së Kosovës, me përvojë të konsiderueshme në ndërtimin e objekteve banesore dhe komerciale, ku në një numër rastesh kemi qenë njëkohësisht investitor dhe punëkryes i drejtpërdrejtë i projekteve. Projektet tona janë realizuar në përputhje me të gjitha standardet ligjore, teknike dhe urbanistike të vendit ku janë zhvilluar.

Sqarimi dhe Kërkesa jonë:

Në vendin ku ne operojmë (shteti [shëno emrin e shtetit]), procesi i pranimi teknik nuk bëhet nga autoritetet komunale, por është përgjegjësi e kompanive të licencuara private, të cilat janë të certifikuar nga organet shtetërore përkatëse për të kryer inspektime teknike, kolaudime dhe lëshimin e certifikatave për përfundimin e punimeve dhe përputhshmërinë me lejen ndërtimore.

Për këtë arsye, kërkojmë nga ju që: Në vend të kërkesës për “certifikatë të pranimi nga komuna”, të lejohet paraqitja e certifikatave të pranimi teknik të lëshuara nga kompani të licencuara/ të autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar. Kjo praktikë është e zakonshme në shumë vende të Bashkimit Evropian dhe më gjerë, ku sektori privat është i autorizuar të ushtrojë mbikëqyrje teknike dhe të lëshojë dokumentacionin për përfundimin e punimeve ndërtimore.

Arsyetim:

1. Natyra ndërkombëtare e tregut të ndërtimit nënkupton se operatorët ekonomikë nuk mund të kufizohen vetëm në dokumente të lëshuara nga komuna, kur legjislacioni lokal i vendeve të tjera njih formë të tjera të pranimi teknik.

2. Kompanitë private të licencuara nga shteti për kolaudime janë të barasvlershme me autoritetet publike në vendet ku ato veprojnë, dhe dokumentet e lëshuara prej tyre përfaqësojnë vërtetimin zyrtar të përfundimit të punimeve sipas standardeve ligjore.

3. Kërkesa për dokument specifik nga "komuna", në këtë rast, përjashton në mënyrë të paarsyeshme operatorët ndërkombëtarë, duke rrezikuar shkeljen e parimeve të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë. Për këto arsye, ju kërkojmë me mirëkuptim që kriteri i mësipërm të modifikohet dhe të mundësohet pranimi i dokumenteve ekuivalente të lëshuara nga entitete të autorizuar sipas ligjit të vendit ku projekti është realizuar. Në veçanti, kërkojmë sqarim dhe rishqyrtim të kërkesës që thuhet si vijon: “Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimi nga komuna, ndërsa për OE pretendues për kontratë, AK do i verifikojë transaksionet bankare të projekteve private.” Ne jemi Operator Ekonomik i regjistruar jashtë Republikës së Kosovës, me përvojë të konsiderueshme në ndërtimin e objekteve banesore dhe komerciale, ku në një numër rastesh kemi qenë njëkohësisht investitor dhe punëkryes i

drejtpërdrejtë i projekteve. Projektet tona janë realizuar në përputhje me të gjitha standardet ligjore, teknike dhe urbanistike të vendit ku janë zhvilluar.

Sqarimi dhe Kërkesa jonë:

Në vendin ku ne operojmë, procesi i pranimi teknik nuk bëhet nga autoritetet komunale, por është përgjegjësi e kompanive të licencuara private, të cilat janë të certifikuara nga organet shtetërore përkatëse për të kryer inspektime teknike, kolaudime dhe lëshimin e certifikatave për përfundimin e punimeve dhe përputhshmërinë me lejen ndërtimore. Për këtë arsye, kërkojmë nga ju që: Në vend të kërkesës për “certifikatë të pranimi nga komuna”, të lejohet paraqitja e certifikatave të pranimi teknik të lëshuara nga kompani të licencuara/ të autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar. Kjo praktikë është e zakonshme në shumë vende të Bashkimit Evropian dhe më gjerë, ku sektori privat është i autorizuar të ushtrojë mbikëqyrje teknike dhe të lëshojë dokumentacionin për përfundimin e punimeve ndërtimore.

Arsyetim:

1. Natyra ndërkombëtare e tregut të ndërtimit nënkupton se operatorët ekonomikë nuk mund të kufizohen vetëm në dokumente të lëshuara nga komuna, kur legjislacioni lokal i vendeve të tjera njih formë të tjera të pranimi teknik.
2. Kompanitë private të licencuara nga shteti për kolaudime janë të barasvlershme me autoritetet publike në vendet ku ato veprojnë, dhe dokumentet e lëshuara prej tyre përfaqësojnë vërtetimin zyrtar të përfundimit të punimeve sipas standardeve ligjore.
3. Kërkesa për dokument specifik nga "komuna", në këtë rast, përjashton në mënyrë të paarsyeshme operatorët ndërkombëtarë, duke rrezikuar shkeljen e parimeve të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë.

Përgjegjja e AK

Sa i përket pretendimit të dytë për investitor privat, pajtohem me këtë pretendim dhe do korrigjohet kriteri, zbutet kërkesa për investitor privat dhe të pjesa e deshmise, lejohet ose certifikatë të pranimi nga Komuna ose Certifikata të pranimi teknik të lëshuara nga Kompani të licencuara / të autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar.

3. Kriteret e përvojës përjashtojnë padrejtësisht një numër të madh operatorësh ekonomikë të kualifikuar

Në vend të aplikimit të parimit të proporcionalitetit për të lehtësuar konkurrencën, AK ka vendosur kritere që kufizojnë ndjeshëm numrin e operatorëve që mund të marrin pjesë.

Pranimi i bashkëpunimit në konsorcium është i mirë, por nuk përbën zëvendësim të trajtimit të barabartë për çdo operator.

Pyetja III Në kuadër të përgatitjes së dokumentacionit për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit [Numri i Prokurimit: 206-25-80-5-1-1 Titulli “Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti”, kemi shqyrtuar me kujdes kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dosjen e tenderit, përkatësisht kriterin që lidhet me përvojën relevante në realizimin e projekteve të ngjashme. Sa i përket pretendimit të tretë për mundësinë e pranimi si përvojë relevante të një projekti banesor kolektiv, ne ju sqarojmë se pranohen projektet banesore kolektiv për plotësimin

e kërkeses se AK ge ofertuesi te kete realizuar me sukses projekte të ngjashme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 30 Milion Euro, ndersa mbetet ne fuqi kërkesa qe ne kuader të projekteve të ketë realizuar të paktën një kontratë me vlerë se paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim te një objekti shëndetësor (kërkohet për liderin ne rast te grupit). Objektet shendetesore jane shume me specifike sasa objektet e banimit kolektiv, andaj kërkesa e AK eshte ligjore dhe mese e nevojshme per kete aktivitet.

Në specifikim thuhet: “Të ketë realizuar të paktën një kontratë me vlerë së paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim të një objekti shëndetësor (kërkohet për liderin në rast të grupit). Nuk pranohen objektet individuale, projektet infrastrukture, rrugë, nënkalime, ura, ujësjellës, kanalizim e të ngjashme.” Duke marrë për bazë këtë kërkesë, me anë të kësaj letre, ju drejtohem me respekt për të kërkuar një sqarim zyrtar lidhur me mundësinë e pranimi si përvojë relevante të një projekti banesor kolektiv, për të cilin:

- Operator Ekonomik (OE) ka qenë njëkohësisht investitor dhe punëkryes i drejtpërdrejtë (pra, ka pasur përgjegjësi të plotë për projektimin, ndërtimin dhe financimin e objektit);
- Objekti ka qenë i destinuar për përdorim nga publiku ose për qëllime të banimit kolektiv dhe është ndërtuar sipas të gjitha standardeve teknike, ligjore dhe urbanistike në fuqi;
- Vlera totale e investimit/ndërtimit është e barabartë ose më e lartë se 8 milionë euro;
- Objekti nuk është individual, por përbëhet nga një kompleks ose njësi të mëdha banesore me karakter publik ose të hapur për treg.

Arsyetim :

Konsiderojmë se, edhe pse objekti nuk është "shëndetësor" në kuptimin e ngushtë, ndërtimi i një objekti banesor kolektiv me kompleksitet teknik dhe vlerë të krahasueshme mund të përfaqësojë përvojë të vlefshme në kuptim të kapaciteteve teknike, organizative dhe financiare të kërkuara për zbatimin e projekteve të mëdha ndërtimore. Po ashtu, në rastet kur operatori ekonomik është investitor dhe njëkohësisht zbatues, ai mban përgjegjësi të plotë për të gjitha aspektet e projektit – duke përfshirë planifikimin, menaxhimin financiar, përmbushjen e kërkesave teknike dhe përfundimin me sukses të projektit.

Kërkesa jonë :

Me këtë rast, kërkojmë nga autoriteti kontraktues të na konfirmojë në mënyrë zyrtare nëse një përvojë e tillë – pra, ndërtimi i një objekti banesor kolektiv me vlerë mbi 8 milionë euro, ku OE është investitor dhe punëkryes – mund të konsiderohet për qëllim të përmbushjes së kriterit të kërkuar për përvojë relevante, sipas dokumentacionit të 8/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK tenderit.

Pyetja IV

Ne ju drejtohem me këtë kërkesë për rishqyrtim të formulimit të njërit prej kriterëve për përvojë të mëparshme, konkretisht pjesës që përjashton: “Nuk pranohen objektet individuale, projektet infrastrukture, rrugë, nënkalime, ura, ujësjellës, kanalizim e të ngjashme.” Kërkesa jonë: Kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të bëjë rishqyrtimin e këtij kufizimi, me qëllim që të pranohen edhe projektet infrastrukture në të cilat janë realizuar punime ndërtimore të ngjashme me natyrën e punimeve të projektit aktual, veçanërisht ato që përfshijnë:

- punë betoni të përmasave të mëdha, montim konstruksionesh,
- punime të kanalizimeve dhe ujësjellësve,
- rikonstruksione të sistemeve ekzistuese,
- dhe elementë të tjerë që gjenden zakonisht edhe në ndërtimet civile.

Arsyetim:

1. Në shumë projekte infrastrukturore, përfshirë ato të ujësjellësit dhe kanalizimit, realizohen punime të rëndësishme ndërtimore dhe inxhinierike, si p.sh. vepra betoni, rezervuarë nëntokësorë, mure mbajtëse, vepra teknike, strukturë shtrati dhe përforcime, të cilat janë të krahasueshme për nga vëllimi dhe kompleksiteti me ato që realizohen në objekte ndërtimore.
2. Në paramasat e punëve të realizuara nga ne në projektet infrastrukturore, janë përfshirë në mënyrë të konsiderueshme pozicione të natyrës ndërtimore – si betonime, armime, punime gjurmimi, sisteme, izolime, dhe instalime teknike – të cilat kërkojnë kapacitete të larta teknike, logjistike dhe organizative.
3. Përjashtimi i këtyre projekteve nuk e reflekton realisht kapacitetin dhe përvojën teknike të operatorëve ekonomikë, të cilët kanë realizuar projekte të mëdha infrastrukturore, por që janë të aftë për të përballuar edhe projekte ndërtimore të natyrës civile ose institucionale.
4. Një qasje më fleksibile dhe gjithëpërfshirëse do të mundësonte rritjen e konkurrencës dhe përfshirjen e operatorëve me përvojë reale dhe të dëshmuar, në vend që të kufizohet vetëm në titullin apo kategorinë e projektit. Për këto arsye, kërkojmë me mirëkuptim që ky kusht të riformulohet në mënyrë që të lejohet vlerësimi i përvojës në projektet infrastrukturore me arsyen sepse edhe vet ky projekt përfshinë të gjitha këto pozicione, për aq kohë sa dokumentohet se ato përmbajnë pozicione të natyrës ndërtimore të krahasueshme me objektin e kontratës në fjalë. Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe mbetemi në pritje të përgjigjes suaj zyrtare.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Ne si Autoriteti Kontraktues e kemi shqyrtuar me kujdes kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe konsiderojmë se është i pabazuar pretendimi juaj i parë në lidhje me kërkesën e NJK dhe DT që në kuadër të projekteve të ketë realizuar të paktën një kontratë me vlerë së paku tetë (8) milionë euro për ndërtim ose renovim të një objekti shëndetësor.

Vlera e parashikuar e këtij projekti është afër 28 milionë euro dhe kërkesa për së paku një projekt të ngjashëm prej tetë (8) milionë euro është plotësisht ligjore për një aktivitet të tillë.

Kërkesa e AK është e analizuar mirë, duke marrë parasysh se ne kemi lejuar që përveç si ndërtim të pranohet edhe renovim, çka e shton mundësinë e konkurrencës, andaj konsiderojmë se të gjitha kriteret e tenderit janë të arsyeshme duke marrë parasysh qëllimin, vlerën, kategorinë dhe natyrën e aktivitetit.

Ne si AK kemi përvojë jo të mirë në të kaluarën pikërisht me këtë projekt, i cili ka mbetur në gjysmë nga OE paraprak dhe për ne është shumë me rëndësi që punëkryesi i ardhshëm të jetë kompani profesionale dhe me kapacitetet e nevojshme për realizimin e projektit, andaj edhe nuk kemi përpiluar shumë kritere por pak e të duhura, por natyrisht se mund të ketë OE të pakënaqur

por edhe OE që nuk mund t'i arrijnë këto kërkesa.

Sipas LPP-së lejohet qarkullimi financiar në tre vite max. 2 fishi i vlerës edhe referencat max. 1.5 e vlerës, por ne i kemi kërkuar shumë më ulët këto vlera që të jenë të përballueshme për ofertuesit e mundshëm.

Sikur të kërkoreshin maksimumet e lejuara, vlerat do ishin shumë më lartë se sa vlerat e kërkuara dhe me siguri që ju do ankoheshit edhe më shumë në to.

Edhe në projekte tjera të ngjashme kemi pranuar oferta edhe nga jashtë vendit, andaj edhe në këtë rast OE vendor e kanë mundësinë e bashkëpunimit në konsorciume me OE të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit.

Sa i përket pretendimit të dytë për investitor privat, pajtohem me këtë pretendim dhe do korrigjohet kriteri, zbutet kërkesa për investitor privat dhe te pjesa e dëshmisë, lejohet ose certifikatë të pranimit nga komuna ose certifikata të pranimit teknik të lëshuara nga kompani të licencuara/të autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar.

Sa i përket pretendimit të tretë për mundësinë e pranimit si përvojë relevante të një projekti banesor kolektiv, ne ju sqarojmë se pranohen projektet banesore kolektive për plotësimin e kërkesës së AK që ofertuesi të ketë realizuar me sukses projekte të ngjashme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 30 milionë euro, ndërsa mbetet në fuqi kërkesa që në kuadër të projekteve të ketë realizuar të paktën një kontratë me vlerë së paku tetë (8) milionë euro për ndërtim ose renovim të një objekti shëndetësor (kërkohet për liderin në rast të grupit). Objektet shëndetësore janë shumë më specifike sesa objektet e banimit kolektiv, andaj kërkesa e AK është ligjore dhe mësë e nevojshme për këtë aktivitet.

Sa i përket pretendimit të katërt që të pranohen objektet individuale, projektet infrastrukturore, rrugë, nënkalime, ura, ujësjellës, kanalizim e të ngjashme, ky pretendim është i papranueshëm dhe plotësisht i pabazë duke marrë parasysh natyrën e këtij projekti. Projekte të tilla infrastrukturore nuk kanë të bëjnë me natyrën e objektit të tenderuar nga AK-MSH.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 26.05.2025, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar,
- AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Lidhur me pretendimet e OE ENG Construction SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0338 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Ndërtimin e Objektit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti” me nr. të prokurimit: "206-25-80-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar në fazë të kritereve.

OE ankues i pakënaqur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK ka vendosur kërkesa në kundërshtim me nenet: 7, 7.1 dhe 61 të Ligjit për Prokurim Publik.

Pretendimet e OE ankues:

1. Kërkesa për përvojë specifike në një projekt shëndetësor mbi 8 milion euro është diskriminuese dhe jo proporcionale Kjo kërkesë është e tepërt duke marrë parasysh që:

Kërkesa për një kontratë të vetme të realizuar prej 8 milion euro vetëm për objekte shëndetësore përjashton padrejtësisht operatorë ekonomikë që kanë realizuar projekte të ngjashme në kompleksitet dhe vlerë, por në sektorë të ndryshëm si banim kolektiv ose projekte të tjera ndërtimore civile.

AK vetë pranon që projektet banesore kolektive pranohen si përvojë për qëllime të tjera të kriterit (30 milion euro në total), por refuzon të pranojë një kontratë të vetme banesore si ekuivalente për një objekt shëndetësor.

Ky është një standard i dyfishtë dhe krijon avantazh të padrejtë për një pjesë të operatorëve ekonomikë

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 30 Milion Euro, të përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Në kuadër të projekteve të këtyre realizuar të paktën një kontratë me vlerë se paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim të një objekti shëndetësor (kërkohet për liderin në rast të grupit). Nuk pranohen objektet individuale, projekte infrastrukturore, rrugë, nënkalime, ura, ujësjellës, kanalizim, etj të ngjashme. Në rast të grupit të o.e, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Dëshmia 1. Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar.

Lista duhet t'i ketë këto të dhëna:

- Titullin kontratës,
- Investitori,
- Të dhënat e personit kontaktues,
- Datën e përfundimit të projektit,
- Vlerën e projektit.

Për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (të perkohshme ose finale).

Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimit nga komuna, ndërsa për OE pretendues për kontratë AK do i verifikoj transaksionet bankare të projekteve private.

Dhe rrjedhimisht bazuar në neni 69 par.6, 6.2 të Ligjit për Prokurim Publik gjithashtu Rregulloren për Prokurim Publik nr. 001/2022 neni 25 par. 13 dhe 26.10:

Citat:

69.6. Në procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla; në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë të dhëna përkitazi me:

69.6.2. listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, autoriteti kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me autoritetin publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse t’ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;

25.13 Rrpp: “Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Operatori Ekonomik të dëshmojë që në përputhje me nenin 69 të LPP-së, në të kaluarën ka përfunduar kontrata të një natyre të ngjashme me një vlerë të caktuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, e cila nuk mund të caktohet më shumë se 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës. Kjo nënkupton se Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesën për qarkullim specifik nëse ka përfunduar një apo disa kontrata të një natyre të ngjashme që vetëm ose së bashku arrijnë totalin e vlerës së specifikuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe nuk kërkohet që kjo kërkesë në vlerën e përcaktuar prej 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës të plotësohet vetëm me një kontratë të vetme të asaj vlere”

Neni 26.10 RRPP:

26.10 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se, ku AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE.

Si e tillë ekspertja sqaron se, AK sa i përket vlerës minimale 30,000,000.00 euro karshi vlerës së parashikuar, nuk e tejkalon 1.5 herë, dhe në rastin konkret, marrë parasysh natyrën e projektit dhe punëve të cilat do të realizohen gjithashtu edhe përgjigjen e AK-së në kërkesën për rishqyrtim, i cili deklaron se ky aktivitet ka dështuar herën e kaluar për shkak të mungesës së eksperiencës së operatorit ekonomik fitues, atëherë me qëllim që kontrata dhe projekti të realizohet me sukses kërkohet përvoja e operatorit ekonomik në lëmin e ndërtimit të objektit

shëndetësor, gjegjësisht nga lideri i cili përfaqëson grupin dhe gjithashtu siguron se Lideri të përmbushë pjesën e kërkesave me qëllim që të përmbushet realizimi i kontratës. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

Pretendimi i dytë i OE ankues:

2. Përjashtimi i projekteve të natyrës infrastrukturore, individuale apo të ngjashme nuk ka bazë ligjore dhe është në kundërshtim me vet natyrën e punimeve të tenderuar

Autoriteti Kontraktues ka përjashtuar në mënyrë të paarsyeshme projektet e natyrës infrastrukturore, projektet ndërtimore individuale, si dhe të tjera të ngjashme (si nënkalime, ujësjellës, kanalizime), pa ofruar asnjë bazë ligjore konkrete që justifikon këtë përjashtim.

Kjo bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë dhe proporcional të operatorëve ekonomikë dhe përjashton padrejtësisht shumë subjekte që kanë përvojë të dëshmuar në projekte me kompleksitet, volum dhe standarde të krahasueshme.

Më tej, vetë dokumentacioni i tenderit, përkatësisht paramasat e punimeve të përgatitura nga Autoriteti Kontraktues, përfshijnë një volum të konsiderueshëm të punimeve të natyrës infrastrukturore: si rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit, punime të rrugës, punime të jashtme, etj.

Si e tillë, kërkesa për përvojë të detyrueshme vetëm në objekt shëndetësor, ndërkohë që natyra teknike e punimeve ka shumë elemente të punimeve inxhinierike /infrastrukturore, është jo vetëm e pajustificuar, por edhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me përmbajtjen e vetë tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues sqaron se, natyra e aktivitetit të prokurimit është ndërtimi i objektit të spitalit e cila në paramasë gjithashtu ka të përfshirë pozicione të ujësjellësit, kanalizimit, atëherë meqenëse vlera e projekteve të përfunduara si kërkesë është e madhe dhe AK gjithashtu ka ndarë kërkesën si eksperiencë që kërkohen së paku 8 milion projekte ndërtim/renovim në objekte shëndetësore atëherë rekomandohet që në kuadër të vlerës 30 milion projekte të merren edhe projektet e kanalizimeve dhe ujësjellësit, andaj pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i tretë i OE ankues:

Sqarimi dhe Kërkesa jonë:

Në vendin ku ne operojmë (shteti [shëno emrin e shtetit]), procesi i pranimi teknik nuk bëhet nga autoritetet komunale, por është përgjegjësi e kompanive të licencuara private, të cilat janë të certifikuara nga organet shtetërore përkatëse për të kryer inspektime teknike, kolaudime dhe lëshimin e certifikatave për përfundimin e punimeve dhe përputhshmërinë me lejen ndërtimore. Për këtë arsye, kërkojmë nga ju që: Në vend të kërkesës për “certifikatë të pranimi nga komuna”, të lejohet paraqitja e certifikatave të pranimi teknik të lëshuara nga kompani të licencuara/ të autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar. Kjo praktikë është e zakonshme në shumë vende të Bashkimit Evropian dhe më gjerë, ku sektori privat është i autorizuar të ushtrojë mbikëqyrje teknike dhe të lëshojë dokumentacionin për përfundimin e punimeve ndërtimore.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me këtë pretendim ankimor të OE ankues sqaron se, AK në kërkesën për rishqyrtim ky i fundit ka aprovuar kërkesë andaj nuk ka nevojë që të zgjerohet, por rekomandohet AK që të modifikoj dosjen e tenderit.

Përgjigja e AK · Sa i përket pretendimit të dytë për investitor privat, pajtohem me këtë pretendim dhe do korrigojohet kriteri, zbutet kërkesa për investitor privat dhe të pjesa e dëshmisë, lejohet ose certifikate të pranimit nga Komuna ose Certifikata të pranimit teknik të lëshuara nga Kompani të licencuara / Te autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar.

Si përfundim, në ankesën e OE ankues pretendimet ankimore si kërkesë për ndryshim në dosje të tenderit kanë të bëjnë me kërkesën në nenin 69 të LPP-së, lidhur me projektet e përfunduara si eksperiencë të operatorit ekonomik aplikues, të cilat sipas sqarimeve më lartë, AK relativisht ka respektuar Ligjin e Prokurimit Publik, mirëpo me qëllim që të hapet konkurrenca gjithnjë duke mos rrezikuar që çmimi më i ulët të devijoj kërkesën dhe realizimin e kontratës me sukses, atëherë rekomandohet AK që sipas përshkrimeve në përgjigje të pretendimeve ankimore të modifikoj kërkesat, të ndryshoj dosjen e tenderit dhe të bëjë zgjatjen e afatit për dorëzim të ofertave.

-Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkëlqeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE"ENG Construction" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes Dosjes së tenderit/Njoftimit për kontratë, ku Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE"ENG Construction" SH.P.K, janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik me rastin e hartimit të kërkesave Dosjes së Tenderit/Njoftimit për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti" me numër të prokurimit; 206-25-80-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimit ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik OE"ENG Construction" SH.P.K., aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me Dosjen e Tenderit/Njoftimi për kontratë, obligohet Autoriteti kontraktues, të bëjë përmirësimet në Dosje të Tenderit-Njoftimit për Kontratë në harmoni me nenin 53 të LPP-se, sipas vlersimeve/përgjigjeve në pretendimet ankimore si të bazuara dhe pjesërisht të bazuara, nga raporti ekspertit shqyrtues, të mbështetura nga Paneli shqyrtues dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Po ashtu ndër të tjera Paneli shqyrtues kriterin në Dosjen e tenderit- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1..... Në kuadër të projekteve të ketë realizuar të paktën një kontratë me vlerë se paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim të një objekti shëndetësor (kërkohet për liderin në rast të grupit), PSH kete kerkese e konstaton si joproporcionale, diskriminuese dhe kufizon tregun e operatoreve ekonomik te interesuar, andaj duhet te permisohet nga AK kjo kerkese, ashtu qe te pranohen dhe objektet banesore kolektive, pasi qe aktiviteti i prokurimit ka te bëjnë me ndërtim.

Paneli shqyrtues konsideron se ankesa është e bazuar pjesërisht, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK lidhur me atë nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenet 7, 27, 69 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe

përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjeserishëm të ankese të OE"ENG Construction" SH.P.K., vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - ENG Construction SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: